



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Nr. 817/10 Prot.

Tiranë, më 30.12.2016

**V E N D I M**

**Nr.170, Datë 30.12.2016**

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË  
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR  
“MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË  
SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE DHE  
VLERËSIMI I PROJEKTEVE “NDËRTIMI I BY-PASS FIER” DHE  
“NDËRTIMI BY-PASS VLORË”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimi mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe vlerësimi i projekteve “Ndërtimi i by-pass Fier” dhe “Ndërtimi by-pass Vlorë”, të ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, nga fillimi i projektit deri më datë 31.08.2016.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

- Për procedurën e tenderit të ndërtimit By-pass Fier, ftesa për tender është bërë më datë 12.07.2007 dhe hapja e ofertave më datë 05.09.2007. Me shkresën e ish-Drejtorit të Përgjithshëm z.A.T., nr. 3697 prot. datë 07.05.2008, është miratuar fituesi i tenderit "S.", me vlerë oferte 51,577,256.52 Euro. Me shkresën e ish-Ministrit të MPPT nr. 4637/1 prot. datë 25.06.2008, përcillet shqetësimi nga Drejtoria e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik-Apoloni, ku ish-Ministri pezullon të gjitha procedurat e rrugës By-pass Fier dhe i lihet detyrë DPRR (sot ARRSH), të studiojë zgjidhjen, duke rishikuar projektin sipas gjurmës së re. Me vendimin nr. 70 datë 06.04.2010 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA), përcaktohen zonat e nevojshme që duhet të kryen sondazhe arkeologjike. Vendim i cili ka zgjatur për një periudhë 22 mujore. Me shkresën e ish-Ministrit të MPPT nr. 2522/1 prot. datë 05.05.2010, bazuar vendimit të KKA, i lihet për detyrë DPRR realizimi i projektit të detajuar të variantit të ri nëpërmjet konsulentit, që njëkohësisht është dhe projektuesi i këtij segmenti rrugor, si dhe fillimin e procedurave të tenderit të zbatimit.

-Nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për të nxitur Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë, për të miratuar projektin arkeologjik, i cili ka zgjatur për një periudhë 22 muaj.

-ARRSH ka shpallur procedurat e prokurimit në një kohë kur për ndërtimin e By-passit të Fierit nuk është bërë i mundur sigurimi i burimeve financiare. Nuk është shpjeguar pse janë ndjekur procedurat e prokurimit të BERZH dhe pse raporti përfundimtar është miratuar vetëm nga BEI.

-Nga auditimi u konstatua se fondet e akorduara nga këto dy Banka janë bërë efektive me ratifikimin në Parlament të Marrëveshjeve përkatëse, pra 5 vite pasi është hapur procedura e tenderit të parë. Gjithashtu ARRSH nuk ka dhënë ose nuk ka bërë të ditur se kush do të jenë financuesit e projektit dhe nga do sigurohen burimet financiare.

### ***Për sa më sipër rekomandojmë***

*- ARRSH të marrë masa që në të ardhmen për investimet strategjike, që në fazën e projektimit të bashkëpunojë dhe të nxisë Institucionet e përfshira në projekt, në mënyrë që mos të ketë vonesa për implementimin e projekteve.*

*-ARRSH të marrë masa që në të ardhmen të nis zhvillimin e procedurave të prokurimit për projektet me financime të huaja, pas ratifikimit në Parlament të marrëveshjeve financiare dhe bërjes efektive të burimeve të financimit.*

***Në vazhdimësi***

## **2. Gjetje nga auditimi:**

-Projekti “Ndërtimi i By pass-it të Fierit”, ka si qëllim ndërtimin e një By-pass-i me gjatësi 22 km në qytetin e Fierit. Projekti sipas Marrëveshjeve financiare është përcaktuar të përfundonte brenda tremujorit të fundit të vitit 2015. Nga auditimi u konstatua se ky afat nuk ka mundur të përmbushet, deri në fund të muajit gusht 2016 realizimi i punimeve të ndërtimit është në masën 50%, ndërsa realizimi kohor është në masën 117%.

Afati i përcaktuar për përfundimin e ndërtimit të By-pass Fier datë 26.05.2015. Palët kanë rënë dakord që të bëjnë rishikim të afatit të përfundimit dhe kanë përcaktuar datën 04.04.2016. Në fakt edhe ky afat nuk është përmbushur dhe aktualisht kontrata e punimeve është në proces.

Nga ARRSH nuk është marrë asnjë masë për të përcaktuar dhe për të rënë dakord me kontraktorin për përcaktimin e një afati për përfundimin e punimeve, si dhe për hartimin e grafikut të miratuar të punimeve. Aktualisht nga data 04.04.2016 midis ARRSH dhe kontraktorit “S.” nuk ka një marrëdhënie kontraktuale të zyrtarizuar, ku të përcaktohet se kur parashikohen të përfundojnë punimet, si dhe të përcaktohen të gjitha të drejtat e detyrimit. Një fakt tjetër paradoksal është edhe ai që kontrata e mbikëqyrjes së punimeve për By-pass-in Fier është me afat deri më datë 31.12.2016, situatë kjo e cila tregon për formalitetet dhe veprime fiktive, si në menaxhimin e kësaj kontrate dhe të projektit.

### ***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Nga ARRSH, Njësia e Zbatimit të Projektit dhe konsulenti, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një grafiku punimesh dhe një plani të detajuar pune, me qëllim që të përcaktohet afati i përfundimit të punimeve për ndërtimin e By-pass të Fierit. Gjithashtu të merren masa për të nënshkruar një amendament për shtyrjen e afatit, për shkak se nga data 04.04.2016 e në vazhdimësi nuk ka kontratë të nënshkruar midis palëve ARRSH dhe kontraktorit “S.”.*

***Menjëherë***

## **3. Gjetje nga auditimi:**

-Operatori i shpallur fitues në procedurën e dytë të tenderimit për By-pass Fier, “S. C.” spa, është konsideruar nga KVO si ofertë anomalisht e ulët, të cilit i janë kërkuar analizat e çmimeve për verifikime të kostove të zbatimit. Gjithashtu kjo ofertë është konsideruar anomalish e ulët edhe nga Banka BERZH, por kjo e fundit ka kërkuar të rritet garancia e kontratës në masën 20% me vlerë 8,718,465 euro, në mënyrë që të sigurohet përfundimi i investimit. Nga auditimi u konstatua se lidhja e kontratës së punimeve me çmimet e ofertuar ka sjell vështirësi gjatë zbatimit të projektit dhe për të reduktuar çmimet e ofertuar, kontraktori ka propozuar ndryshime thelbësor të projekt-preventivit, me qëllim që të minimizojë humbjet dhe të rris

fitimin, veprime këto të cilat kanë rënduar negativisht jo vetëm financiarisht koston e projektit, por edhe zbatimin në kohë.

Nga dinamika e zbatimit të kontratës së By-pass-it të Fierit, kontraktori ka dështuar në realizimin e investimit brenda afateve të përcaktuara në kontratë, ku një nga shkaqet e vonesave janë çmimet anomalish të ulëta, veprime këto që kanë sjellë si pasojë shkeljen e kushteve fillestare të tenderit, duke mos i trajtuar të barabartë operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë.

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- *ARRSH të marrë masa që në të ardhmen për investimet me financime të huaja, në rastet kur ofertat janë anomalisht të ulëta dhe kanë zbritje nga vlera e përlogaritur e kontratës në masën mbi 50 %, KVO bashkë me Konsulentin dhe Këshillin Teknik të shqyrtojnë ofertat ekonomike, analizat e kostove, si dhe të merren masa për mos lidhjen e kontratave të tilla.*

- *ARRSH në të ardhmen të marrë masa për investimet me financime të huaja, në rastet kur një kontraktor është duke zbatuar një projekt dhe oferton për projekt tjetër me çmim të favorshëm, duhet ti kërkojë listën e mjeteve, stafin e punës, organizimin e zbatimit etj, në mënyrë që të mos paraqitet risk për vonesa gjatë zbatimit të punimeve dhe të eliminojë vonesat në realizimin e projekteve.*

***Në vazhdimësi***

**4. Gjetje nga auditimi:**

- Në kontratën e konsulencës dhe mbikëqyrjes të ndërtimit për By-pass-in Fier, nuk është paraqitur ose parashikuar stafi minimal i punës së konsulencës, për rastet kur kontrata e punimeve është e pezulluar pjesërisht ose plotësisht, veprim ky në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe të termave të referencave të tenderit, artikulli 13 “Ri-programimi i grupit të punës në lidhje më pezullimet apo zgjatjet e punimeve”.

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

-*ARRSH bazuar në kontratën e shërbimit të konsulencën dhe mbikëqyrjes, duhet të marri masa të plotësojnë parashikimet për staf minimal në punën e konsulentit në periudhat kur punimet e ndërtimit janë të pezulluara, në mënyrë që fondet e parashikuara për konsulencën të përdoren me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet.*

***Menjëherë***

**5. Gjetje nga auditimi:**

-Punimet për By-pass-in Fier, duhet të përfundonin më datë **04.04.2016**. Pas kësaj date nga ARRSH nuk disponohet asnjë shtesë afati, grafik punimesh, apo korrespondencë midis palëve mbi marrëdhëniet kontraktuale për

përfundimin e projektit. Në fillim të vitit 2016 kontraktori "S." ka zbatuar punimet me ritme të ulëta, derisa në Mars 2016 ka ndërprerë punimet në kantier. Më datë 27.04.2016 kontraktori "S.", ka ndërprerë marrëdhëniet me nën-kontraktorët C." sh.p.k dhe "E. M." sh.p.k (nën-kontraktor për Bypassin e Vlorës), duke e konsideruar këtë fakt, si shkak për pezullimin e punimeve. *Bazuar kushteve të kontratës neni 4.4 "nën-kontraktorët", përcaktohet se kontraktori nuk mund të nënkontrakttojë të gjitha punët. Kontraktori do mbajë përgjegjësi për të gjitha veprimet apo shkeljet e secilit nën-kontraktor, agjentëve dhe të punonjësve të tij, sikur të ishin veprimet dhe shkeljet e Kontraktorit.* Problematika midis kontraktorit dhe nën-kontraktorëve të punimeve ka vazhduar me dinamika me procese gjyqësore, duke penguar zbatimin e punimeve. ARRSH ka paralajmëruar për aplikimin e penalteteve sipas nenit 8 të kontratës "Dëmet ditore" dhe maksimumit të dëmeve në 10 % të kontratës në vlerë 4,125,346 euro për By-pass-in e Fierit dhe i ka njoftuar mbarimin e kontratës në vlerë 8,718,465 euro në rast se nuk përmirëson progresin e punimeve.

-Nga auditimi konstatohet se me shkresën nr. 6275 prot. datë 27.07.2016 hyrje në ARRSH, nga shoqëria përmbarimore "B." është përcjellë urdhër sekuestro mbi kreditë e debitorit shoqërisë "S.C." s.p.a në shumën **247,504,223 lekë**, për llogari të shoqërive nën-kontraktuese "C." sh.p.k dhe "E. M." sh.p.k. Ekzistenca e Urdhër Sekuestros paraqet risk të lartë për përfundimin e projektit. Nga Interim Payment Certificates Certifikate/situacioni i Pagesës të Ndërmjetme (IPC\_ 14 e cila i përket muajt Dhjetor 2015 e deri në periudhën e auditimit, kontraktori nuk ka paraqitur asnjë certifikatë për pagesë, kjo për shkak të urdhrit të sekuestros.

-Palët nuk kanë dhënë argumente mbi mos përfundimin e investimit, dhe nga dinamika e problemeve, menaxhimi i projektit pa afate të realizimit, jashtë marrëdhënieve kontraktuale, tregon një keq menaxhim të kontratës së punimeve dhe të projektit në tërësi.

#### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- ARRSH të marrë masa që në bashkëpunim me konsulentin të zgjidhin çështjet e kontraktorit, në mënyrë që të sigurohet përfundimi i investimit brenda një kohe të arsyeshme.

- ARRSH të marrë masa për hartimin e një grafiku punimesh nga kontraktori, në mënyrë që të ndiqet ecuria e punimeve edhe në By-pass Vlorë.

-ARRSH të marrë masa dhe të analizojë situatën për ngërçin e shkaktuar nga kontraktori i punimeve nga mosparaqitja për pagesë e situacioneve për një periudhë 10-mujore, në një kohë që punimet janë realizuar.

***Menjëherë***

#### **6. Gjetje nga auditimi:**

-Referuar letrës më të fundit të ARRSH datë 27.07.2016 drejtuar "S.", i është kërkuar kësaj të fundit që më datë 26.08.2016 të paraqes për aprovim

tek supervizori një Program Pune të detajuar se si do të arrijë të rikuperojë kohën e humbur për përmbushjen e kontratës për By-pass Fier, programi i cili nuk është hartuar dhe si rrjedhojë nuk është miratuar.

-Nga sa më lart rezulton se kërkesa datë 27.07.2016 e ARRSH drejtuar kontraktorit është bërë në një kohë që me këtë kontraktor nuk ka një kontratë zyrtare ose amendament të firmosur dhe të rënë dakord nga palët. Gjithashtu, mënyra se si ARRSH i ka dhënë zgjidhje përfundimit të punimeve të ndërtimit është e pabazuar ligjërisht dhe e ka lënë në diskrecion të kontraktorit dhe të supervizorit të punimeve përfundimin e projektit. Duke qenë para kësaj situate, si dhe duke parë dinamikën e problemeve të kontraktorit me nën-kontraktorin, nga ekzistenca e urdhër sekuestrove për llogaritë e kontraktorit për shumën 247,504,223 lekë, arrijmë në konkluzionin se projekti ka një risk të lart për mos përfundimin e plotë të tij. Projekti nuk ka arritur që të përmbushë dhe realizojë parimin e 3-E-ve, që ka të bëjnë me ekonomikitetin (zbatimi me kosto sa më të ulët), efektivitetin (përfundimin në afat) dhe efikasitetin (shfrytëzimi në kohë sa më të shpejtë i investimit). **Pra aktualisht nuk është arritur të përmirësohet udhëtimi kohor dhe i sigurt, në veçanti përmes trafikut, si dhe nuk është lehtësuar kongjestioni dhe problemet mjedisore në qytetin e Fierit.**

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

*-ARRSH, PIU në bashkëpunim edhe me konsulentin, të bëjnë një analizë të detajuar mbi ecurinë e projektit dhe të marrin masa për të dhënë një zgjidhje për finalizimin sa më të suksesshme të projektit, për arsye se nga dinamika e deritanishme e implementimit të projektit, si dhe nga mospasja e një marrëdhënie kontraktuale të zyrtarizuar midis palëve, realizimi i projektit paraqitet me një risk të lart dështimi.*

***Menjëherë***

**7. Gjetje nga auditimi:**

- Bazuar propozimeve të kontraktorit të miratuara nga mbikëqyrësi i punimeve, Këshilli Teknik i ARRSH me Vendimin nr. 11, datë 02.04.2014 me, ka miratuar, reduktimin e lartësisë së trupit të rrugës, përmirësimin e përforcimit të trupit të rrugës, strukturën e re të urave, të cilat kanë sjellë shmangie në zbatimin e specifikimeve teknike, si dhe në sasitë e punimeve të cilat certifikohen dhe likuidohen. Nga ana e Supervizorit nuk janë kryer kontrole të nevojshme, teste dhe matje të punimeve të paraqitura nga Kontraktori si të realizuara. Pavarësisht se këto punime do të konsolidohen në certifikatën finale, certifikimi i tyre pa u realizuar akoma është në kundërshtim me Pikën 12.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës FIDIC dhe krijon risk humbje në rastin e dështimit të kontraktorit për realizimin e kontratës, ndërprerje të kontratës etj. Propozimet nga kontraktori kanë tjetërsuar plotësisht projektin origjinal të tenderuar, duke e denaturuar procedurën e tenderimit.

### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marri masa me qëllim rritjen e monitorimit të projekteve, nëpërmjet sondazheve të vazhdueshme gjatë realizimit të punimeve, për të siguruar që punimet e certifikuara të jenë në përputhje me sasinë e realizuar në fakt, si dhe të jenë respektuar specifikimet teknike sipas përcaktimeve në kontratë.

- ARRSH dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marri masa që në të ardhmen të zbatojë projektet dhe specifikimet e tenderuara në mënyrë që të sigurohet trajtim i barabartë dhe me transparencë të gjithë operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e tenderit.

### ***Në vazhdimësi***

### **8. Gjetje nga auditimi:**

- Propozimi i reduktimit të lartësisë së trupit të rrugës, bazuar raportit hidrologjik-hidraulik konstatohet se nuk është paraqitur me hartën e rrezikut nga përmbytjet e zonës, të modeluar në 2D (2 Dimensional). Në bazë të hartës së përmbytjeve dhe rezultatet e marra nga modeli i saj, nuk janë kryer konfirmimet nga Bordi i Kullimit dhe Drejtoria e Ujërave përkatëse, si dhe nuk është vënë në dijeni Ministria e Bujqësisë për situatën që do të krijohej. Përcaktimi i kuotave/niveleve të rrugës dhe shkarkimet e tombinove, nuk janë marrë nga harta e përmbytjeve. Në raportin hidrologjik (llogaritjet hidraulike), nuk janë paraqitur efektet që sjellin fryrjen e kanaleve, ku llogaritjet janë bërë plotësisht lokale dhe aspak reale. Parametrat hidraulik të vendosur në seksionet e raportit nuk janë sipas kushteve të terrenit por në kushte ideale, ku për të marrë parametrat real të një tërthori (seksioni), duhen parë seksionet afërsisht 200 m para atij seksioni dhe 600 m pas atij seksioni, sipas rekomandimeve të programit llogaritës i përdorur në rastin konkret.

-Nga auditimi, rezultoi se raporti hidrologjik-hidraulik fillestar i vitit 2011 për projektin “Ndërtimi i By-pass Fier”, realizuar nga projektuesi “S. & S. & T.”, i cili njëkohësisht është edhe mbikëqyrësi/konsulenti i zbatimit të punimeve, krahasuar me raportin hidrologjik të paraqitur nga kontraktori dhe realizuar nga shoqëria Italiane “S. B.” studio di ingegneria e geologia applicata, në vitin 2014, **janë plotësisht të njëjtë**. Në raportin e hartuar në vitin 2014 nuk është pasqyruar asnjë ndryshim në lidhje me situatën hidrologjike-hidraulike të projektit, dhe si rrjedhojë nuk kuptohet se kush është logjika se përse “duhej” një raport në vitin 2014 kur raportet janë thjeshtë kopjime dhe se i **vetmi ndryshim i tyre është logo e shoqërive që e kanë paraqitur. Projekti hidrologjik i vitit 2014, është miratuar edhe nga konsulenti/mbikëqyrësi i punimeve, dhe si rrjedhojë ka miratuar raportin e hartuar nga vetë ai (konsulenti) në vitin 2011. E gjithë kjo praktikë tregon për veprime falsifikuese, fiktive dhe tepër formale, dhe si pasojë edhe ndryshimet e kërkuara dhe të miratuara nga Këshilli Teknik i ARRSH, për këtë pjesë (hidraulike) në Variation Order/Urdhër Ndryshimi (VO) janë të pabazuara dhe kanë si qëllim**

**vetëm rritjen e kostos së zërave të punimeve dhe të kontratës së punimeve dhe për përfitim të padrejtë të kontraktorit.**

- Me vendimin nr. 11 datë 02.04.2014 të Këshillit Teknik, janë miratuar uljet e kuotave të rrugës (lartësia e trupit të rrugës), propozuar nga kontraktori, pa u mbështetur në arsyetime teknike të argumentuara, por faktikisht është mbështetur në raportin hidrologjik, i cili në të dy vitet kur është paraqitur (viti 2011 dhe viti 2014) është i njëjtë. Propozimi i kontraktorit është miratuar fillimisht nga konsulenti, i cili është njëkohësisht edhe projektuesi i projektit të tenderuar, por njëkohësisht ka miratuar po të njërin projekt të paraqitur nga një projektues tjetër (S. B.), por ky i fundit ka ndryshuar edhe specifikimet teknike dhe preventivin e punimeve, të cilat janë pjesë integrale e kontratës së punimeve.

Ndryshimi i kuotave të projektit të rrugës me të njëjtin studim hidrologjik-hidraulik, tregon një menaxhim të dobët të ARRSH, duke denaturuar projektin e tenderuar dhe duke krijuar risk të lart të mundshëm për përmbytjen në disa segmente të rrugës.

#### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

*- Këshilli Teknik i ARRSH, të marrë masa për ristudimin e zonës të aksit të rrugës, për të bërë të mundur eliminimin e përmbytjeve për arsye se nga ndryshimet e bëra ne VO e miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik nr. 11 datë 02.04.2014 dhe nga treguesit Hidrologjik-Hidraulik janë në parametrat e kufijve për përmbytje të mundshme.*

***Menjëherë***

#### **9. Gjetje nga auditimi:**

-Për realizimin e komponenti B “Konsulentë dhe mbikëqyrje e punimeve të By-pass Fier”, më datë 21.07.2010 është firmosur kontrata ndërmjet ARRSH dhe bashkimit të operatorëve “S. & S. & T.”, me vlerë 715,800 Euro (pa tvsh). Gjithashtu, edhe për këtë kontratë, ashtu si për atë të punimeve, nuk ka një deadline (datë përfundimtare) për realizimin e saj. Për realizimin e kësaj kontrate, do të lindë domosdoshmërisht nevoja për rishikim të vlerës së kontratës.

-Për periudhë e auditimit janë kryer gjithsej 12 pagesa në shumën gjithsej 772,378 euro dhe ka mbetur për tu likuiduar shuma **471,129 euro**. Nga auditimi u konstatua se shtesa e vlerës së do të sigurohet nga fondet e Cooperacione Italiane dhe pala shqiptare ARRSH/Buxheti i Shtetit. Në fakt shtesa që Cooperacione ka rënë dakord të vë në dispozicion dhe që e ka miratuar dhe lëvruar është në shumën 142,410 euro ose në masën 20% të shtesës së kontratës, ndërsa pjesa tjetër e shtesës në shumën 385,297 euro do të përballohet nga buxheti i ARRSH. **Në fakt nga auditimi u konstatua se ARRSH vetëm sa ka cituar në shkresat se shtesa e kontratës në shumën 385,297 euro do të përballohet nga Buxheti i Shtetit, por ndërkohë nuk është marr asnjë masë për sigurimin e këtij fondi, nuk është kërkuar dhe**



**argumentuar në MF kjo shumë, ndonëse kontrata e shtesës është lidhur më datë 03.02.2016 me vlerë të shtesës 527,707 euro.**

-Pagesa e fundit e kryer për shërbimin e konsulencës dhe mbikëqyrjes është bërë më datë 09.06.2016. Nga kjo datë e në vazhdimësi fondi që ARRSH ka në dispozicion dhe efektiv për pagesat në vazhdimësi është 85,832 euro nga Cooperazione Italiane, ndërsa pjesën tjetër në shumën **385,297 euro** nuk ka fonde të akorduar nga buxheti i shtetit dhe nuk është ndërmarr asnjë praktikë për sigurimin e tij. Duke u gjendur para këtyre fakteve ARRSH është hasur me vështirësi në pagesat e konsulentit për mungesë të fondeve, situatë e cila ka rritur riskun për claim-e të mundshme për kontraktorin, pasi ky i fundit ka shfaqur shenjat e para për pretendimet e claim-eve.

-Nga sa më lart rezulton se është lidhur shtesa e kontratës midis palëve, pa u siguruar më parë burimi i financimit, veprim ky në kundërshtim me Marrëveshjet financiare të BEI dhe BERZH dhe me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*-ARRSH/PIU të marrin masa që në bashkëpunim me konsulentin të parashikojnë se nëse do të lind nevoja dhe domosdoshmëria për fonde shtesë për shërbimin e mbikëqyrjes si dhe për çdo shërbim tjetër, më parë të sigurohen fondet e nevojshme dhe me bërjen efektive të tyre (fondeve) të merret vendimi përkatës.*

*-ARRSH dhe PIU të marrin masa me qëllim që në të ardhmen të mos lidhi kontrata sipërmarrje ose shtesa kontratash pa u siguruar më parë burimi i financimit dhe pa u siguruar fondet e nevojshme, siç është vepruar në shtesën e kontratës së konsulentit dhe mbikëqyrjes për By-pass-in e Fierit, për arsye se veprime të tilla jo vetëm që janë në kundërshtim me ligjin për MFK, por rrisin edhe riskun për kosto shtesë të projektit për pagesa të claim (vonesë në shlyerje pagesash) në favor të kontraktorit.*

***Menjëherë***

**10. Gjetje nga auditimi:**

Projekti “Ndërtimi i By pass-it të Vlorës”, ka si qëllim ndërtimin e një By-pass-i me gjatësi 29 km në qytetin e Vlorës. Projekti sipas Marrëveshjeve financiare është përcaktuar të fillojë në tremujorin e katërt të vitit 2014 dhe të përfundojë brenda datës 30 qershor 2017.

-Nga auditimi u konstatua se problematikat dhe vonesat në zbatimin e punimeve për By-pass e Vlorës janë të njëjta me ato për By-pass Fier, pra vonesa të shkaktuara nga marrëdhëniet që kontraktori “S” ka patur me nënkontraktorin. Kjo problematikë ka rezultuar me bllokim të kantierit për një periudhë prej rreth 3-muaj, agravime, greva, shkresa të ARRSH drejtuar Kontraktorit, nënkontraktorit, MTI, Policisë së Shtetit, etj. Aktualisht kjo problematikë vazhdon në procese gjyqësore midis Kontraktorit “S.” dhe

nën-kontraktorit "E. M.". Progresi i punimeve për By-pass e Vlorës, deri në Qershor 2016 ka qenë mjaft i ulët (4%), madje për periudhën shkurt-maj 2016 ka qenë pothuaj i pezulluar aktiviteti në kantier.

-Megjithëse, me prishjen e kontratës më këtë nën-kontraktor dhe me aktivizimin e disa nën-kontraktoreve të tjerë lokal dhe të huaj, aktiviteti në kantier është rritur, por prapë nuk është mundur të rikuperohet koha e humbur nga vonesat e deritanishme.

-Nga treguesit e realizimit të disbursimeve rezulton se edhe dibursimet për ndërtimin e By-pass Vlorë kanë ecur me ritme shumë të ulëta. Është disbursuar vetëm 10.7% e shumës së financimit dhe 16.1% e vlerës së kontraktuar për realizimin e projektit. Nga auditimi u konstatua se pagesa e fundit e kryer për punimet e ndërtimit është IPC e muajit Dhjetor 2015 dhe për periudhën 10 mujore janar – tetor 2016, nuk është certifikuar asnjë situacion dhe si rrjedhojë nuk është kryer asnjë pagesë. E njëjta situatë është edhe për kontratën e mbikëqyrjes të këtij By-pass-i. Kjo situatë disbursimi tregon se nga ARRSH dhe PIU nuk kanë bërë një menaxhim të mirë të Projektit, situatë e cila ka rritur riskun e mos përfundimit të tij (projektit) brenda afatit të përcaktuar.

-Gjithashtu, problematika e hasur në procesin e shpronësimeve ka sjellë vonesa në zbatimin e punimeve, si dhe nga ana e kontraktorit të punimeve janë ngritur disa pretendime për shtyrje të afatit ose llogaritje të claim, pasi vonesat janë si pasojë e veprimtarisë së punëdhësit (ARRSH).

### ***Për sa më lart rekomandojmë:***

*-ARRSH dhe PIU të marrin masa të menjëhershme për analizimin e ecurisë së punimeve të ndërtimit për By-pass e Vlorës, për arsye se nga vonesat e shkaktuara nuk është e mundur që punimet e ndërtimit të realizohen brenda afatit të përcaktuar. Nga ARRSH në bashkëpunim me konsulentin dhe kontraktorin të hartohet një program pune, ku të detajohet grafiku i punimeve në vazhdimësi, si dhe të përcaktohet një afat i arritshëm për përfundimin e projektit.*

*-ARRSH, PIU dhe Sektori i Shpronësimeve, të marrin masa që për pjesën e mbetur të projektit, të sigurojnë të gjitha të drejtën mbi tokë apo truallin ku do të kalojë gjurma e projektit, për arsye se vonesat në procesin e shpronësimit ngarkojnë me përgjegjësi ARRSH, e cila sipas marrëveshjeve financiare duhet ti kishte siguruar këto të drejta para fillimit të punimeve për By-pass-in.*

***Menjëherë***

### **11. Gjetje nga auditimi:**

-Për procedurën e ndërtimit të By-pass Vlorë, BERZH dhe BEI, kanë miratuar "Raportin e Rishikuar të Vlerësimit të Ofertave" të KVO-së, me fitues operatorin "S. C." i cili është i njëjti zbatues për By-pass Fier. Gjithashtu është rekomanduar të rritet garancia e kontratës në masën 20% të vlerës së Kontratës, për arsyen e riskut që paraqet oferta e ulët e "S. C." .

Nga KVO nuk është shqyrtuar dinamika e ngjarjeve në By-passin e Fierit, ku i njëjti kontraktor i shpallur fitues, zbaton punimet në ritme shumë të ulëta dhe KVO nuk ka marrë në konsideratë faktin e riskut të vonesave të zbatimit në By-passin e Vlorës, pasi duhej të shqyrtonte faktin se mjetet dhe stafi i kontraktorit "S. C.", janë në marrëdhënie kontraktuale për zbatimin e kontratës së By-passit të Fierit.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*-ARRSH të marri masa që në të ardhmen gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të shqyrtojnë me përparësi ofertat teknike të operatorëve ekonomik, të cilët janë në marrëdhënie kontraktuale me ARRSH gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, për më tepër kur objekti i tenderimit është i njëjtë/ngjashëm me atë të kontratës në proces.*

***Në vazhdimësi***

**12. Gjetje nga auditimi:**

-Për realizimin e projektit By-pass Vlorë është përcaktuar që të jetë i ndarë në dy komponentë:

A. "Për supervizionin dhe mbikëqyrjen e punimeve" dhe B. "Për punimet e ndërtimit". Për realizimin e dy komponentëve pas zhvillimit të procedurave të prokurimit, janë lidhur dy kontrata.

Nga auditimi u konstatua se kontrata e supervizionit dhe mbikëqyrjes për By-pass e Vlorës lidhur më datë 22.11.2013 me shoqërinë "E. O.", ka si datë të fillimit datën 10.03.2015 ose 10 muaj pas afatit të përcaktuar, i cili përkon brenda datës 22.05.2014. Nga përcaktimi i bërë në neni 19, rezulton se afati i realizimit të kontratës do të jetë data 22.01.2017. Kontrata e punimeve për ndërtimin e By-pas Vlorë është parashikuar që të përfundojë realizimin brenda datës 13.10.2017.

Pra nga sa më lart rezulton se kontrata e mbikëqyrjes përfundon afërsisht 10 muaj para kontratës së punimeve dhe kjo mos përputhje afatesh nuk është rregulluar nga palët. Nga PIU/ARSH, i cili është dhe përgjegjës për vonesën e fillimit të kontratës së mbikëqyrësit, nuk është marrë asnjë masë për të njoftuar Komisionin Evropian (KE) për të bërë ndryshimin e afatit të implementimit të kontratës, me qëllim edhe shmangien e kostove shtesë për këtë kontratë.

-Në fakt nga auditimi u konstatua se nga ecuria e punimeve të ndërtimit në by-pass e Vlorës dhe nga pretendimet e kompanisë "S.", për pagesën e situacioneve, si dhe nga stopimi i punimeve në këtë by-pass, afati i përcaktuar për realizimin në datë 13 tetor 2017, nuk do të mund të arrihet. Rrjedhimisht me shtyrjen e afati të punimeve do lind nevoja e rishikimit të aftit për kontratën e mbikëqyrësit, e cila duke qenë se është kontratë që paguhet me kohë do të shoqërohet me kosto shtesë.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*-ARRSH dhe PIU të marrin masa për të siguruar fondet e nevojshme në lidhje me kostot shtesë për kontratën e mbikëqyrjes për “By-pass-in Vlorë”, për arsye se shtyrja e afati të punimeve të ndërtimit rrjedhimisht do të kërkojë edhe rishikim të afatit për kontratën e mbikëqyrësit, e cila duke qenë se është kontratë që paguhet me kohë do të shoqërohet me kosto shtesë.*

*-ARRSH të marri masa që me zgjatjen e afatit të kontratës së punimeve të rishikojë edhe afatin e realizimit të kontratës së konsulentit dhe mbikëqyrësit, kontrata të cilat aktualisht nuk kanë të njëjtin afat.*

***Menjëherë***

### **13. Gjetje nga auditimi:**

-Kontrata për ndërtimin e By-pass të Vlorës lidhur më datë 19.03.2015 midis kompanisë “S. C.” me vlerë 35,289,872 euro pa tvsh. Data e fillimit të punimeve është 15.04.2015. Nga auditimi u konstatua se shuma e disbursuar për këtë kontratë është në shumën 5,111,068 euro ose në masën 14.4% të vlerës së kontraktuar.

-Nga auditimi u konstatua se progresi i punimeve për By-pass e Vlorës ka ecur me ritme shumë të ulëta dhe kontraktori ka premtuar në mbledhjet mujore se punimet në kantier do të rifillonin brenda datës 20 maj 2016, cituar ky fakt edhe në memo-n nr. 2464 datë 04.04.2016 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, ndërsa në fakt puna ka rifilluar në fund të muajt qershor 2016 dhe deri në fund të muajit shtator 2016 punimet kanë ecur me ritme më normale. Këtë situatë e dëshmojnë dhe shifrat e realizimit, ku realizimi fizik është në masën 5.6%, realizimi financiar në masën 14% dhe realizimi kohor në masën 60%, pra tregues të cilët janë në përpjesëtim të zhdrejtë me njëri -tjetrin.

### ***Për sa më lart rekomandojmë:***

*- ARRSH dhe PIU të marrin masa për të njoftuar zyrtarisht kontraktorin e punimeve për penalitetet për vonesat e shkaktuara, të cilat nuk kanë lindur nga mos përmbushja e detyrimeve të punëdhënësit (ARRSH)*

*-ARRSH, PIU në bashkëpunim me konsulentin dhe kontraktorin e punimeve të marrin masa për të analizuar vazhdimësinë e Projektit me ritme normale.*

***Menjëherë***

### **14. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi u konstatua se bashkë financues për ndërtimin e By-pass Vlorë, janë bankat BEI, BERZH dhe Komisioni Evropian në shumën 17 milionë euro në formë granti nga fondet e IPA -2011, të cilat do kanalizohen nëpërmjet bankës BERZH. Marrëveshja financiare për fondet IPA është ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë me ligjin nr. 52/2015 datë 14.05.2015 dhe ky fond është bërë efektiv më datë **30.10.2015**, njoftim i cili është bërë me fax nga banka BERZH.

Në fakt rezulton se fondi i financimit të IPA është bërë efektiv afërsisht 7 muaj pas lidhjes së kontratës së punimeve, si dhe vetë kontrata e punimeve është lidhur dy muaj para se të bëhej ratifikimi i marrëveshjes financiare për fondet

IPA. Pra kontrata e punimeve është lidhur para se të sigurohej e gjithë shuma e financimit ku fondet e IPA janë në masën 32.08% të totalit të kontratës, veprim ky në kundërshtim me marrëveshjen financiare të datës 30.11.2011, e lidhur midis Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Evropian për programin IPA 2011, në të cilin është përcaktuar se shuma e grantit për punimet e By-pass Vlorë do të bëhen efektive me ratifikimin e marrëveshjes financiare në Parlament, si dhe dy marrëveshjet bankave BEI dhe BERZH.

Për më tepër, gjatë periudhës nga lidhja e kontratës deri në momentin e bërjes efektive të fondeve IPA (datë 30.10 2015), nga ARRSH janë miratuar dy pagesa për kontratën e punimeve në shumën gjithsej 4,333,012 euro, nga të cilat shuma 1,364,237 euro duhet të likuidohen nga fondet IPA. Në fakt kjo shumë nuk ka mundur të likuidohet, për arsye se fondet IPA nuk kanë qenë efektive dhe si rrjedhojë ARRSH ka miratuar pagesa pa siguruar më parë burimet e financimit, si dhe janë shkaktuar vonesa në pagesat e kontraktorit, veprime këto në kundërshtim me marrëveshjet financiare të BEI, BERZH dhe IPA 2011, si dhe ligjin e MFK.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*ARRSH dhe PIU të marrin masa me qëllim që në të ardhmen të mos nisin procedurat e prokurimit, të mos lidhin kontrata sipërmarrje dhe të mos miratojnë pagesa pa u bërë më parë ratifikimi në Parlament i marrëveshjeve financiare dhe bërja efektive e të gjitha fondeve, të cilat akordohen nga donatorë të ndryshëm për projektet dhe investimet me financime të huaja, pasi për By-pass-in Vlorë janë miratuar pagesa pa u siguruar më parë burimi i financimit dhe pasjen e tyre në dispozicion.*

***Në vazhdimësi***

**15. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi u konstatua se Njësia e Zbatimit të Projektit për të dy projektet nuk ka dorëzon te Banka/BEI informacionin në përmbajtje, formë dhe kohën, e specifikuar në skedulën/formularin A.2 ose siç është rënë dakord në kontratën e financimit, veprim ky në kundërshtim marrëveshjet financiare të Bankës BEI.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Njësia e Zbatimit të Projektit të marri masa që në vazhdimësi dhe deri në përfundimin e plotë të dy projekteve të përgatit dhe të dorëzoj te Banka BEI, informacion mbi ecurinë e projektit, sipas formularëve A.2, të cilët janë pjesë integrale e Marrëveshjeve financiare.*

***Menjëherë***

**16. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi u konstatua se në nenin 3 të marrëveshjeve të BERZH është përcaktuar se për realizimin e projekteve do të funksionojë një Ekip i

Zbatimit të Projektit (EZP) me burime të mjaftueshme dhe personel të kualifikuar. Nga auditimi rezulton se EZP përbehet nga personeli i Sektorit të Zhvillimit të Projekteve të Huaja, pjesë e strukturës së ARRSH. Në datën 03.11.2015 specialistja/financiere e këtij sektori është larguar dhe aktualisht ky sektor nuk ka në përbërjen e tij një specialist/ekonomist dhe vetëm autorizimi për kryerjen e pagesave i është deleguar Drejtorit të Personelit. Mungesa e specialistes së financës ka sjell dhe mos mbajtjen e llogarive të projekti, librave kontabël dhe hartimit të pasqyrave financiare të projektit rreth një periudhe një vjeçare, veprim ky në kundërshtim me marrëveshjet financiare.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*ARRSH të marrë masa për plotësimin me specialiste financiare të stafit të Ekipit të Zbatimit të Projektit/Sektorit të Zhvillimit të Projekteve të Huaja, në përputhje me marrëveshjet financiare dhe për të siguruar mbajtjen sa më të saktë dhe reale të llogarive të projekteve.*

***Menjëherë***

**B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:**

- Propozimi për përmirësimin e përforcimit të trupit të rrugës ka sjellë zëra të rinj punimesh në kapitullin 2 “Përgatitja e terrenit dhe punimet e dheut” të cilët janë; NP (New price) 04 “*Trajtim me çimento të argjinaturës*” me çmim **7.26 euro** dhe NP 13 “*Trajtim me gëlqere të argjinaturës*” me çmim **7.85 euro**. Në zërin 02.03.02 “Formimi i argjinaturave”, në përputhje me kushtet e miratuara sipas klauzolës 4.4 të specifikimeve teknike” ka çmimin përkatësisht **0.75 euro**. Mbështetur në specifikimet teknike për “Formimin e trupit të rrugës”, propozimet e kontraktorit, kanë ndryshuar specifikimet teknike të kushteve të tenderit. Zërat e rinj NP 04 dhe NP 13, kanë rritur kostot e formimit të trupit të rrugës megjithëse janë ulur sasisë e mbushjes nga reduktimi i lartësisë së trupit të rrugës. Deri në IPC 14 janë paguar 147.410 m<sup>3</sup> (NP 04) me vlerë total 1,070,196 euro. Në përputhje me specifikimet teknike të tenderit, ku duhej zgjedhur materiali i përshtatshëm për formimin e argjinaturave, ku sipas sasisë 147.410 m<sup>3</sup>, me çmimin e zërit 02.03.02 në vlerë 0.75 euro/m<sup>3</sup>, vlera duhej të ishte 110,557 euro dhe referuar pagesës së kryer në IPC 14, ka rezultuar një rritje të kostos me efekt negativ financiar është 959,639 euro. Për zërin NP 13, deri në IPC 14 janë paguar 326.711 m<sup>3</sup> me vlerë total 2,564,685 euro. Në përputhje me specifikimet teknike të tenderit, pasi duhej zgjedhur materiali i përshtatshëm për formimin e argjinaturave sasia 326,711 m<sup>3</sup>, me çmimin e zërit 02.03.02 në vlerë 0.75 euro/m<sup>3</sup>, vlera duhej të ishte 245,033 euro duke shkaktuar rritje të kostos me efekt negativ financiar është 2,319,651 euro. Rritja e kostove

për formimin e argjinaturave të trupit të rrugës, ku është ndryshuar projekti i tenderuar, arrin në vlerën  $(959,639 + 2,319,651 - 36,591) = 3,242,699$  euro e cila paraqitet si efekt negativ financiar, jo në përputhje me parimet e eficensës, ekonomicitetit dhe efektivitetit të veprës, duke mos zbatuar projektin fillestar, specifitimeve teknike dhe kushtet e tenderit.

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- *Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Këshilli Teknik, të marrë masa për rivlerësimin e ndryshimeve të projekt – preventivit për përmirësimin e përforcimit të trupit të rrugës, të cilat kanë sjellë rritje të vlerës së parashikuar në shumën 3,242,699 euro, shumë e përfituar nga kontraktori në kundërshtim me termat e referencave të tenderit dhe kontratën e punimeve.*

***Menjëherë***

**2. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi u konstatua se në fillim të vitit 2016, për projektin “Ndërtimi i By-pass Fier”, kontraktori “S” ka performuar me ritme të ulëta dhe të ngadalta dhe në muajin Mars 2016, një muaj para përfundimit të afatit përfundimtar të rishikuar, ka ndërprerë totalisht punimet. Hyrja në kantier dhe fillimi i punimeve janë bërë të mundura vetëm pas datës 19.08.2016.

-Me gjithë vonesat e konstatuara nga ARRSH janë bërë vetëm paralajmërime për nxitjen e kontraktorit për të rifilluar punimet, por nuk ka njoftuar zyrtarisht atë (kontraktorin) se për shkak të vonesave të cilat nuk kanë ardhur si pasojë e punëdhënësit apo për shkaqe të jashtëzakonshme (si parashikohen në kontratë), i ka lindur detyrimi i pagesës së penalteteve.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

-ARRSH dhe PIU të marrin masa që në zbatim të kontratës të punimeve neni 8, ti kërkoj në rrugë zyrtare kontraktorit “S” dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore, për arkëtimin e vlerës në shumën 4,125,346 euro, penaltete për vonesat e shkaktuara gjatë punimeve të ndërtimit, për arsye se këto vonesa nuk janë shkaktuar nga punëdhënësi (ARRSH).

***Menjëherë***

**3. Gjetje nga auditimi:**

Nga kontraktori për projektin e “Ndërtimit të By-pass-it Fier”, është propozuar struktura e re e urave, të cilat konsistojnë në heqjen e këmbës qendrore të urave dhe përdorimi i elementeve metalik (model kapriade). Propozimi është parë duke reduktuar interferimin e rrjedhës së lumit dhe rritjen e efektivitetit të punës në kohën e dimrit duke përfituar kohë në zbatim e kontratës. Propozimi i iniciuar nga kontraktori përbën ndryshim destinacioni të projektit duke e ndryshuar preventivin, sasi të dhe teknologjinë e punës në kundërshtim me ofertën e kontraktorit paraqitur në

tender. Preventivi i rishikuar ka pësuar shtesa në zëra të rinj punimesh, rritje të kostos 1,959,914 euro në kapitullin 3 "Beton për urat dhe këmbët e themeleve" dhe ulje të kostos në kapitullin 4 "Urat, soleta në sistemin e trarëve prej çeliku" prej 571,414 euro. Në total rritja e kostove për 2 kapitujt është **1,388,500 euro pa TVSH**. Realizimet e strukturave të urave, janë ende në proces dhe koha e menduar për tu përfituar nga ARRSH, nuk ka arritur objektivin nga zbatuesi. Ndryshimit të projektit të urave pa ndonjë shkak madhor të arsyeshem teknik, përveç lehtësimit së ndërtimit të urave në favor të kontraktorit, kanë sjellë zëra të rinj punimesh dhe teknologji tjetër punimi, duke vepruar në kundërshtim me dokumentet e tenderit dhe kontratën e lidhur.

***Për sa më lartë rekomandojmë:***

- *Këshilli Teknik dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrë masa të rivlerësojë, ndryshimin e projekt-preventivit të strukturave të urave në situacionin e pagesave, të cilat kanë sjellë rritje të vlerës së parashikuar në shumën **1,388,500 euro** e përfituar nga kontraktori në kundërshtim me termat e referencave të tenderit dhe kontratën e punimeve.*

***Menjëherë***

**4. Gjetje nga auditimi:**

-Në mbushjet e trupit të rrugës, nuk janë zbritur volumet që zënë tombinot gjatë gjithë mbushjeve të rrugës. Në mbushjet e rrugës përfshihet; stabilizim i tokës natyrale me thellësi mesatare 20 cm, stabilizim i tokës natyrale me thellësi mbi 40 cm, gërmimet e përbashkëta nga karrierat, formimi i argjinaturave, stabilizimi i argjinaturave me gëlqere, trajtim i argjinaturave me çimento, në vlerën **139,433 euro pa TVSH**.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

-*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të marrin masa për të zbritur nga situacioni i pagesave të Kontraktorit "S.C." vlerën **139,433 euro**, vlerë e likuiduar e përfituar padrejtësisht nga mos zbritja e sipërfaqeve që zënë tombinot në mbushjet e trupit të rrugës.*

***Menjëherë***

**5. Gjetje nga auditimi:**

Propozimi i rritjes së thellësisë së tokës natyrale ka sjellë rritjen e thellësisë së stabilizimit të tokës natyrale, duke shtuar zërin e ri të punimeve NP 02. Bazuar kushteve fillestare të tenderit dhe specifikimeve teknike zëri i ri i punimit NP 02 "Stabilizim i tokës natyrale deri në 40 cm", është mbivendosje e punimeve, duke rritur çmimin nga **3.15 euro** "Për thellësi minimale stabilizimi 20 cm" në **4.07 euro** "Për thellësi stabilizimi deri në 40 cm". Deri në IPC 14 është paguar 144.585,23 m<sup>3</sup> me çmimin 4.07 në vlerë 588,461.89 euro e cila edhe në librezën e masave nuk është argumentuar dhe



ku kontraktori duhej të paguhej me çmimin e ofertuar, sipas klauzolave të specifikimeve teknike, 3.15 euro dhe vlera duhej të ishte 455,443.47 euro. Diferenca prej **133,018 euro pa TVSH**, është përfituar padrejtësisht nga kontraktori që përbën dëm ekonomik për ARRSH dhe buxhetin e Shtetit.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*-Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të marri masa për të zbritur nga situacioni i pagesave të Kontraktorit "S.C." vlerën **133,018 euro**, vlerë e likuiduar e përfituar padrejtësisht nga mbivendosja e zërit të punimeve, në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

***Menjëherë***

**6. Gjetje nga auditimi:**

- Në librezën e masave dhe profilet tërthorë të mbushjes zëri NP 13 "Trajtim me gëlqere të argjinaturës ose mbushjes së trupi të rrugës" nga km 9+700 deri në 10+300, nuk pasqyrohen sipërfaqet e mbushjes për zërin përkatës por sipërfaqe mbushjeje argjinature në zërin 02.03.02 "Formimi i argjinaturave", ku sasia prej 10.840,13 m<sup>3</sup> me vlerë **85,095 euro pa TVSH**, është përfituar padrejtësisht nga kontraktori.

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

*-Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të marri masa për të zbritur nga situacioni i pagesave të Kontraktorit "S.C." vlerën **85,095 euro**, vlerë e likuiduar e përfituar padrejtësisht në mënyrë të pajustificuar në zërin "Formimi i argjinaturave".*

***Menjëherë***

**7. Gjetje nga auditimi:**

-Për periudhën objekt auditimit për kontratën e konsulentit dhe mbikëqyrjes për projektin "Ndërtimi i By-pass Fier" janë kryer gjithsej 12 pagesa në shumën totale 772,378 euro.

Nga auditimi u konstatua se për pagesat e konsulentit, nuk janë bërë ndalesa e tatimit të të ardhurave. Kompania "S & S & T", nuk rezulton se është subjekt rezident në vendin tonë dhe nuk është regjistruar në QKR. Nga PIU/ARRSH nuk është kërkuar dhe nuk është bërë ndalesa e tatimit në burim për të ardhurat e përfituar nga kompania dhe të gjeruara në territorin e RSH. Për kontratën e konsulentit nuk është mbajtur për çdo pagesë tatimi në burim, veprim ky në kundërshtim me nenet 4, germa "c" dhe "h", 7 si dhe nenin 33, germa "d" e pika 2, të ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" me ndryshimet përkatëse, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tij, me nenet 6 pika 1, 8 pika 2 dhe 9 të ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSh", Udhëzimin e MF nr. 24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" neni 41, si dhe me Udhëzimin e MF nr. 6, datë 10.02.2004 "Për marrëveshjet

bilaterale për shmangen e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”.

-Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se kompania nuk ka plotësuar dhe dorëzuar në ARRSH ose në Drejtorinë e Tatimeve, formularët për shmangien e tatimit të dyfishtë, në zbatim të marrëveshjes bilaterale për shmangen e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal.

Nga sa më sipër rezulton se për Buxheti e Shtetit është shkaktuar **një dëm ekonomik në shumën 92,386 euro**.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*ARRSH dhe PIU të marrin masa për arkëtimin e vlerës 92,386 euro, nga kompania “S & S & T”, dëm ekonomik i ardhur nga mos mbajtja e tatimit mbi të ardhurat e krijuara nga shërbimi i realizuar në Shqipëri për projektin “Ndërtimi i By-pass të Fierit”.*

*-Gjithashtu nga ARRSH dhe PIU të merren masa që edhe për pagesat në vazhdimësi për shërbimin e konsulencës dhe mbikëqyrjes së këtij projekti, të bëhet mbajtja e tatimit mbi të ardhurat për secilën pagesë, ARRSH/Njësia e Zbatimit të Projektit, të kryej rolin e agjentit tatimor për konsulentin në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për sa i përket tatimit mbi të ardhurat.*

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**8. Gjetje nga auditimi:**

Propozimi i rritjes së thellësisë së tokës natyrale sipas klauzolës 4.2.a, nga 20 cm në 40 cm, shoqërohet gjithashtu me rritje kostoje për këtë zë punimi, duke ndryshuar njësinë matëse të zërit të punimit. Deri në IPC 11 zëri i pastrimit të tokës natyrale është paguar me njësinë matëse me metër katror dhe në certifikatën e pagesës IPC 12 është konvertuar me njësinë matëse metër kub. Kontraktori në IPC 11 është paguar për sasinë 758.397 m<sup>2</sup> me çmimin 0.12 euro në vlerë 91,007 euro dhe në IPC 12 konvertohet njësia matëse 286.774 m<sup>3</sup> (e llogaritur me thellësi afërsisht 0.37 cm) ku gjithashtu konvertohet përkatësisht me çmimin 0.6 euro/m<sup>3</sup> në vlerë 172,064 euro, ku për këtë zë punimi ka një rritje kostoje e përfituar padrejtësisht nga kontraktori në vlerën prej **97,268 euro** deri në IPC 12.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*-Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të marri masa për rregullimin e njësisë matëse në përputhje me specifikimet teknike të tenderit dhe të zbresin nga situacioni i pagesave të Kontraktorit “S” vlerën 97,268 euro e llogaritur deri në IPC 12, vlerë e likuiduar e përfituar padrejtësisht nga ndryshimi i specifikimeve teknike, në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

***Menjëherë***

## **9. Gjetje nga auditimi:**

-Për gërmimet arkeologjike, kontraktori në situacionin 14 është likuiduar me tepër, nga puna e realizuar prej nën-kontraktorit të përcaktuar për punimet arkeologjike, në vlerën **57,035 euro pa TVSH**.

### ***Për sa më lart rekomandojmë:***

-Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të marri masa për të zbritur nga situacioni i pagesave të Kontraktorit "S.C." vlerën **57,035 euro**, vlerë e likuiduar e përfituar padrejtësisht në mënyrë të pajustificuar.

***Menjëherë***

## **10. Gjetje nga auditimi:**

- Në IPC 14, zëri 02.03.02 "Formimi i argjinaturave" është paguar në sasinë 685,405 m<sup>3</sup> dhe bazuar librezave të masave të llogaritura nga konsulenti, volumi i argjinaturave është 553,832 m<sup>3</sup> të rrugës dhe 66,740 m<sup>3</sup>, në rrugët sekondare. Pra totali i realizuar është 620,572 m<sup>3</sup>, me diferencë të paguar më tepër në sasi prej 64,832 m<sup>3</sup>, në vlerën **48,624 euro pa TVSH**.

### ***Për sa më lart rekomandojmë:***

-Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të marri masa për të zbritur nga situacioni i pagesave të Kontraktorit "S.C." vlerën **48,624 euro**, vlerë e likuiduar e përfituar padrejtësisht në mënyrë të pajustificuar.

***Menjëherë***

## **11. Gjetje nga auditimi:**

-Në analizën e çmimit të ofertës për mbushjen e argjinaturave me çmim oferte 0.75 euro/m<sup>3</sup>, është llogaritur kostoja njësi për rulin me peshë 15 ton (B.RULLO 15-alb) **20.7 €/h**. Ndërsa në çmimin e ri NP. 13 është marrë kostoja njësi për rulin me peshë 15 ton (B.RULLO 15) **25.55 €/h**. Në listën e kostove elementare të paraqitur nga kontraktori me shkresën nr. 1837/1 prot. datë 05.12.2012, paraqiten dy kosto të ndryshme për rul me ngarkesë 15 ton e cila është e paargumentuar. Nga kjo kontradiktë kostosh, njësia e menaxhimit të projektit dhe konsulenti nuk kanë diskutuar këtë fenomen dhe kontraktori ka përfituar koston më të madhe të rulit, pra 25.55 €/h dhe kosto ka rezultuar 0.588 euro. Në qoftë se kostoja për rulin do të ishte e ofertës, çmimi do rezultonte 0.476 me një diferencë **0.112 euro**. Bazuar sasisë së volumit të paguar deri në IPC 14 në 326.711 m<sup>3</sup>, rezulton se kontraktori ka përfituar padrejtësisht nga zbatimi i këtij zëri deri në IPC 14, duke rritur koston e punimit në vlerën **36,591 euro pa TVSH**.

### ***Për sa më lart rekomandojmë:***

-Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga situacioni i pagesave të Kontraktorit "S.C." vlerën **36,591 euro**, vlerë e likuiduar për

*kontradiktë kostosh të analizave të çmimeve, të përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

***Menjëherë***

## **12. Gjetje nga auditimi:**

-Në kapitullin e ndërhyrjeve, zhvendosje dhe pune provizore, kontraktori në situacionin 14 është likuiduar me tepër, nga puna e realizuar prej nën-kontraktorëve të përcaktuar për spostimet e linjave elektrike dhe spostimet e linjave të ujësjellësit dhe KUZ, në vlerën **3,479 euro pa TVSH**.

### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

*-Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të marri masa për të zbritur nga situacioni i pagesave të Kontraktorit “S.C.” vlerën 3,479 euro, vlerë e likuiduar e përfituar padrejtësisht në mënyrë të pajustificuar.*

***Menjëherë***

## **B.2. SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFICENCËS DHE EFEKTIVITETIT**

Për shpenzimet të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në koston e Projektit dhe në buxhetin e shtetit, duke sjellë një rëndim të kostove, pasi në realizimin e shpenzimeve që AARSH ka kryer për ndërtimin e By-pass-it Fier, nuk është zbatuar parimi i 3E-ve, Ekonomicitet, Efektivitet dhe Eficiência.

### **1. Gjetje nga auditimi:**

-Për realizimin e komponenti B “Konsulentë dhe mbikëqyrje e punimeve të By-pass Fier”, më datë 21.07.2010 është firmosur kontrata ndërmjet ARRSH dhe bashkimit të operatorëve “S & S & T”, me vlerë 715,800 Euro (pa tvsh). Ky komponent financohet nga Cooperacione Italianë. Afati i kontratës së konsulencës dhe mbikëqyrjes është përcaktuar 27 muaj nga fillimi i punimeve të ndërtimit. Për arsye se, punimet e ndërtimit nuk kanë përfunduar në afat dhe se kontrata e konsulentit ecën paralelisht me atë të punimeve, konstatojmë se kjo kontratë është në proces. Shtyrja e afatit të kontratës së konsulentit është shoqëruar me shtesë të vlerës së saj, për arsye se konsulenti/mbikëqyrësi paguhet me kohë, duke bërë që vlera e rishikuar të jetë 1,243,507 euro (pa TVSH) ose 527,707 euro më shumë se vlera fillestare, ose më tepër në masën 74%. Shtesa e kontratës së konsulencës dhe mbikëqyrjes ka sjell një kosto shtesë për buxhetin e projektit **në shumën 527,707 euro (pa TVSH), duke sjell efekt negativ financiar.**

### ***Për sa më lart rekomandojmë:***

*-ARRSH/PIU të marri masa që në të ardhmen të realizojë zbatimin e projekteve me financime të huaja brenda afateve të përcaktuar në*

*marrëveshjet financiare dhe në kontratat përkatëse, me qëllim arritjen e menaxhimit të mirë të projekteve dhe shmangien e kostove shtesë për realizimin e tyre (projekteve).*

***Menjëherë***

## **2. Gjetje nga auditimi:**

- Me shkresën nr. 1747/1 prot. datë 14.11.2013 të Hekurudhës Shqiptare (HSH), sqarohet distanca e lejuar e ndërtimeve nga shina deri në soletën e mbikalimit duhet të jetë jo më pak se 6.2 m dhe jo 5.05 siç është paraqitur në projekt. Nga Hekurudha Shqiptare sqarohet se duke pasur parasysh perspektivën e sistemit Hekurudhor të dubluar, bazuar standardeve të ndërtimit të linjave hekurudhore të dubluara kërkohet që gjerësia e mbikalimit të jetë 9.2 m dhe nuk pranon gjerësinë e projektit të paraqitur prej 6m. Kontraktori ka paraqitur rishikim të projektit të mbikalimit hekurudhor me përmasa (9.2 x 8 m) e shoqëruar me preventivin përkatës e cila përmban një kosto shtesë prej **214,989 euro**. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk disponohet asnjë plan-projekt strategjik i zhvillimit të Hekurudhës Shqiptare, duke sjellë për projektin e by-pass Fier shpenzim të panevojshëm dhe përdorim të fondeve jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës në shumën 214,989 euro. Nga Hekurudha Shqiptare (HSH) nuk është paraqitur asnjë plan zhvillimi apo plan strategjik për ndonjë projekt i cili mund të implementohet për zhvillimin e Sistemit Hekurudhor i cili përfshin edhe aksin ku interferon me By-passi Fier, si dhe ARRSH nuk ka kërkuar një shpjegim dhe dokumentacion nga Hekurudha Shqiptare, por është mjaftuar për miratimin e ndryshimit vetëm nga kërkesa e Drejtuesve të HSH.

### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

*-ARRSH në të ardhmen për projektet që interferojnë me linjat Hekurudhore, të marrë masa që të argumentojë ndryshimet, bazuar plan-projekteve strategjike Kombëtare, në mënyrë që fondet e akorduara të përdoren me ekonomicitet, eficensë dhe efektivitet, për arsye se miratimet e pastuduara dhe paargumentuara kanë rritur koston e projektit.*

***Menjëherë***

## **3. Gjetje nga auditimi:**

- Me vendimin nr. 70 datë 06.04.2010 Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, përcakton zonat e nevojshme që duhet të kryen sondazhe arkeologjike. Me shkresën e ish-Ministrit të MPPT nr. 2522/1 prot. datë 05.05.2010, bazuar vendimit të KKA, i lihet për detyrë DPRR realizimi i projektit të detajuar të variantit të ri nëpërmjet konsulentit, që njëkohësisht është dhe projektuesi i këtij segmenti rrugor, si dhe fillimin e procedurave të tenderit të zbatimit. Gjithashtu, është përcaktuar se pagesa për rishikimet e projektit do të

vlerësohet bazuar në të njëjta zëra dhe çmime të kontratës së mbikëqyrjes, e cila për rishikimin e projektit ka patur një kosto shtesë prej **93,200 euro**.

-Pagesa e rishikimit të projektit në vlerë prej 93,200 euro, është përdorur në kundërshtim me kontratën e mbikëqyrjes / konsulencës, duke rritur koston për këtë shërbim. Fondet për kryerjen e shërbimit për rishikimin e projektit, nuk janë siguruar nga pala shqiptare, si mënyra e përzgjedhjes së OE që ka hartuar rishikimin e projektit nuk është realizuar sipas ligjit për prokurimin publik, në kundërshtim me marrëveshjen e huas së kooperacionit, në të cilën përcaktohet se fondi i akorduar për By-pass Fier do të përdoret vetëm për shërbimin e konsulencës dhe mbikëqyrjes.

### ***Për sa më sipër rekomandojmë***

- *ARRSH të marrë masa që në të ardhmen për rishikimet e projekteve, në rastet kur fondet nuk sigurohen nga marrëveshjet financiare, të sigurohen nga pala shqiptare, në mënyrë që fondet e parashikuara sipas marrëveshjeve të ratifikuara të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në to. Në rastet e rishikimeve të projekteve mënyra e përzgjedhjes së operatorëve për rishikime apo ristudime të problemeve apo shqetësimeve të Institucioneve Shtetërore, të realizohet sipas ligjit për prokurimin publik, në mënyrë që të respektohen parimet e ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit.*

***Menjëherë***

## **C. MASA DISIPLINORE**

I. Mbështetur në nenet 12 “Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm”, pika 2 të ligjit nr. 10 164 datë 15.10.2009 “Për autoritetin rrugor Shqiptar”, i kërkojmë Ministrin të Transportit dhe Infrastrukturës, që të fillojnë procedurën për shkarkimin nga detyra të:

### ***1. z.D. XH., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe kryetar Këshillit Teknik, për arsye se:***

-Në cilësinë e kryetarit të Këshillit Teknik me vendimin nr. 11 datë 02.04.2014 ka miratuar VO në kundërshtim me projektin e tenderuar dhe specifikimet teknike. Rezultoi se raporti hidrologjik-hidraulik fillestar i vitit 2011 për projektin “Ndërtimi i By-pass Fier”, realizuar nga projektuesi “S & S” & “T”, i cili njëkohësisht është edhe mbikëqyrësi/konsulenti i zbatimit të punimeve, me raportin hidrologjik të paraqitur nga kontraktori, realizuar nga shoqëria Italiane “S. G.” studio di ingegneria e geologia applicata, në vitin 2014, **janë plotësisht të njëjtë**. Në raportin e hartuar në vitin 2014 nuk është pasqyruar asnjë ndryshim në lidhje me situatën hidrologjike-hidraulike të projektit, dhe si rrjedhojë nuk kuptohet se kush është logjika se përse “duhej” një raport në vitin 2014 kur raportet janë thjeshtë kopjime dhe se i **vetmi ndryshim i tyre është logo e shoqërive që e kanë paraqitur.**

**Projekti hidrologjik i vitit 2014, është miratuar edhe nga konsulenti/mbikëqyrësi i punimeve, dhe si rrjedhojë ka miratuar raportin e hartuar nga vetë ai (konsulenti) në vitin 2011. E gjithë kjo praktikë tregon për veprime falsifikuese, fiktive dhe tepër formale, dhe si pasojë edhe ndryshimet e kërkuara dhe të miratuara nga Këshilli Teknik i ARRSH, për këtë pjesë (hidraulike) në VO janë të pabazuara dhe kanë si qëllim vetëm rritjen e kostos së zërave të punimeve dhe të kontratës së punimeve dhe për përfitim të padrejtë të kontraktorit.**

- Me vendimin nr. 11 datë 02.04.2014 të Këshillit Teknik, janë miratuar uljet e kuotave të rrugës (la4,0rtësia e trupit të rrugës), propozuara nga kontraktori, pa u mbështetur në arsyetime teknike të argumentuara, por faktikisht është mbështetur në raportin hidrologjikë, i cili në të dy vitet kur është paraqitur (viti 2011 dhe viti 2014) është i njëjtë. Ndryshimit i kuotave të projektit të rrugës me të njëjtin studim hidrologjik-hidraulik, tregon një menaxhim të dobët të ARRSH, duke denaturuar projektin e tenderuar dhe duke krijuar risk të lart të mundshëm për përmbytjen në disa segmente të rrugës. Dëmi ekonomik i shkaktuara vetëm nga miratimi i vendimi nr.11 i Këshillit Teknik në shumën **1,966,998 euro** dhe efekti negativ në shumën **4,078,595 euro**.

- Ka miratuar pagesa pa siguruar më parë burimet e financimit, si dhe janë shkaktuar vonesa në pagesat e kontraktorit, veprime këto në kundërshtim me marrëveshjet financiare të BEI, BERZH dhe IPA 2011. Bashkëfinancues për ndërtimin e By-pass Vlorë, janë bankat BEI, BERZH dhe Konisioni European në shumën 17 milionë euro në formë grandi nga fondet e IPA -2011, të cilat do kanalizohen nëpërmjetë bankës BERZH. Marrëveshja financiare për fondet IPA është ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë me ligjin nr. 52/2015 datë 14.05.2015 dhe ky fond është bërë efektiv më datë **30.10.2015**, njoftim i cili është bërë me fax nga banka BERZH.

-Fondi i financimit të IPA është bërë efektiv afërsisht 7 muaj pas lidhjes së kontratës së punimeve, si dhe vetë kontrata e punimeve është lidhur dy muaj para se të bëhej ratifikimi i marrëveshjes financiare për fondet IPA, pra kontrata e punimeve është lidhur para se të sigurohej e gjithë shuma e financimit ku fondet e IPA janë në masën 32.08% të totalit të kontratës, veprim ky në kundërshtim me marrëveshjen financiare të datës 30.11.2011, e lidhur midis Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit European për programin IPA 2011, në të cilin është përcaktuar se shuma e grandit për punimet e By-pass Vlorë do të bëhen efektive me ratifikimin e marrëveshjes financiare në Parlament, si dhe dy marrëveshjet bankave BEI dhe BERZH.

-Për më tepër gjatë periudhës nga lidhja e kontratës deri në momentin e bërjes efektive të fondeve IPA (datë 30.10 2015), ka miratuar dy pagesa për kontratën e punimeve në shumën gjithsej 4,333,012 euro, nga të cilat shuma 1,364,237 euro duhet të likuidohen nga fondet IPA. Në fakt kjo shumë nuk ka mundur të likuidohet, për arsye se fondet IPA nuk kanë qenë efektive dhe si rrjedhojë ARRSH ka miratuar pagesa pa siguruar më parë burimet e financimit, si dhe

janë shkaktuar vonesa në pagesat e kontraktorit, veprime këto në kundërshtim me marrëveshjet financiare të BEI, BERZH dhe IPA 2011.

- Afati i përcaktuar për përfundimin e ndërtimit të By-pass Fier datë 26.05.2015 nuk është arritur dhe palët kanë rënë dakord që të bëjnë rishikim të afatit të përfundimit dhe si të tillë kanë përcaktuar datën 04.04.2016. Në fakt edhe ky afat nuk është përmbushur dhe aktualisht kontrata e punimeve është në proces.

-Nuk është marrë asnjë masë për të përcaktuar dhe për të rënë dakord me kontraktorin për përcaktimin e një afati për përfundimin e punimeve, si dhe për hartimin e grafiku të miratuar të punimeve. Aktualisht nga data 04.04.2016 midis ARRSH dhe kontraktorit “S.” nuk ka një marrëdhënie kontraktuale të zyrtarizuar, ku të përcaktohet se kur parashikonte të përfundojnë punimet e këtij By-pass-i, si dhe të përcaktohen të gjitha të drejtat e detyrimet që kanë palët. Një fakt tjetër paradoksal është edhe ai që kontrata e mbikëqyrjes së punimeve për By-pass-in Fier është me afat deri më datë 31.12.2016, situatë kjo e cila tregon për një formalitet dhe veprime fiktive, si dhe për një menaxhim të dobët të kontratave dhe të projektit në përgjithësi.

-Mënyra se si është vepruar me kontratën e punimeve për By-pass Fier është e pabazuar ligjërisht dhe duke e lënë zbatimin në diskrecionin dhe vullnetin e lirë të kontraktorit rrit riskun për mos përfundimin me sukses të projektit.

-Për kontraktorin e punimeve të ndërtimit të By-pass Fier, nuk është ndërmarrë asnjë masë, por vetëm është mjaftuar me paralajmërim për penalitete në një kohë që ky kontraktor ka dështuar në realizimit e investimin brenda afateve të përcaktuara në kontratë, ku një nga shkaqet e vonesave janë çmimet anomalish të ulëta të ofertuara, ku është ndryshuar plotësisht projekt-preventivi i rrugës, ku janë shkelur kushtet fillestare të tenderit dhe duke mos i trajtuar të barabartë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

-Për një menaxhim të keq të kontratës së punimeve për By-pass Fier, ku mosdhënia e argumentimeve nga palët mbi përfundimin e investimit, dinamika e problemeve, menaxhimi i projektit pa afate të realizimit jashtë marrëdhënieve kontraktuale, ka bërë që Projekti të mos përmbush dhe realizojë parimin e 3-E-ve, që ka të bëjnë me ekonomikitetin (zbatimi me kosto sa më të ulët), efektivitetin (përfundimin në afat) dhe eficientë (shfrytëzimi në kohë sa më të shpejt i investimit). **Pra aktualisht nuk është arritur të përmirësohet udhëtimi kohor dhe i sigurt, në veçanti përmes trafikut, si dhe nuk është lehtësuar kongestionin dhe problemet mjedisore në qytetin e Fierit.**

-Për realizimin e komponenti B “Konsulentë dhe mbikëqyrje e punimeve të By-pass Fier”, më datë 21.07.2010 është firmosur kontrata ndërmjet ARRSH dhe bashkimit të operatorëve “S. & S. & T.”, me vlerë 715,800 Euro (pa tvsh). Gjithashtu, edhe për këtë kontratë, ashtu si për atë të punimeve, nuk ka një deadline (datë përfundimtare) për realizimin e saj. Për realizimin e kësaj



kontrate, do të lind domosdoshmërisht nevoja për rishikim të vlerës së kontratës.

-Për periudhë e auditimit janë kryer gjithsej 12 pagesa në shumën gjithsej 772,378 euro dhe ka mbetur për tu likuiduar shuma **471,129 euro**. Nga auditimi u konstatua se shtesa e vlerës së do të sigurohet nga fondet e Cooperacione Italiane dhe pala shqiptare ARRSH/Buxheti i Shtetit. Në fakt shtesa që Cooperacione ka rënë dakord të vë në dispozicion dhe që e ka miratuar dhe lëvruar është në shumën 142,410 euro ose në masën 20% të shtesës së kontratës, ndërsa pjesa tjetër e shtesës në shumën 385,297 euro do të përballohet nga buxheti i ARRSH. Në fakt nga auditimi u konstatua se ARRSH vetëm sa ka cituar në shkresat se shtesa e kontratës në shumën **385,297 euro** do të përballohet nga Buxheti i Shtetit, por ndërkohë nuk është marr asnjë masë për sigurimin e këtij fondi, nuk është kërkuar dhe argumentuar në MF kjo shumë, ndonëse kontrata e shtesës është lidhur më datë 03.02.2016.

-Ka lidhur kontratë shtesë për shërbimin e konsulencës dhe mbikëqyrjes për projektin “Ndërtimi i By-pass Fier” në shumën **527,707 euro (pa TVSH)**, duke sjell rritje të kostos së projektit.

-Ka miratuar dhe ka lidhur kontratë shtesë për mbikëqyrësin e punimeve të By-pass Fier në shumën 385,297 euro, pa siguruar më parë burimet financiare nga buxheti i shtetit dhe nuk është ndërmarr asnjë praktikë për sigurimin e tyre. Veprime këto në kundërshtim me Marrëveshjet financiare të BEI dhe BERZH dhe me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar. Duke u gjendur para këtij fakti, është hasur me vështirësi në pagesat e konsulentit për mungesë të fondeve, situatë e cila ka rritur riskun për claim të mundshme për kontraktorin, pasi ky i fundit ka shfaqur shenjat e para për pretendimet e claim-eve.

-Nuk është bërë një analizë e hollësishme për vonesat e te dy projekteve, si për By-pass Fier dhe By-pass Vlorë, ku të përcaktohen përgjegjësitë si dhe të jepet një zgjidhje optimale për vazhdimësinë e dy projekteve dhe përfundimin me sukses të tyre, për më tepër që në ndërtimin e dy projekteve është kontraktuar i njëjti operator, ci cili ka shfaqur të njëjtat problematika dhe vonesa, si dhe për faktin që ndaj këtij kontraktori ekziston urdhër sekuestro në shumën **247,504,223 lekë**, fakt ky që e vështirëson edhe e rrezikon ecurinë normale të projekteve.

- Nuk ka marrë masa për plotësimin e Ekipit të Zbatimit të Projektit (EZP) me specialiste/financiere, veprim ky në kundërshtim me nenin 3 të marrëveshjeve të BERZH, ku përcaktohet se për realizimin e projekteve do të funksionojë një EZP me burime të mjaftueshme dhe personel të kualifikuar. Në datën 03.11.2015 specialistja/financiere e këtij sektori është larguar dhe aktualisht ky sektor nuk ka në përbërjen e tij një specialist/ekonomist dhe vetëm autorizimi për kryerjen e pagesave i është deleguar Drejtorit të Personelit. Mungesa e specialistes së financës ka sjell

dhe mos mbajtjen e llogarive të projekti, librave kontabël dhe hartimit të pasqyrave financiare të projektit rreth një periudhe një vjeçare, veprim ky në kundërshtim me marrëveshjet financiare.

II. Mbështetur në nenet 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, neni 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe neni 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 115 date 5.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen ne komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së, që të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

*a. “Largim nga shërbimi civil”, neni 58, pika ç, për:*

*1. Z. E. N. me detyrë përgjegjësi i Sektorit të Zhvillimit të Projekteve të Huaja dhe në cilësinë e anëtarit të Këshillit Teknikë, për arsye se:*

-Nuk është njoftuar zyrtarisht kontraktori se për shkak të vonesave të cilat nuk kanë ardhur si pasojë e punëdhënësit apo për shkaqe të jashtëzakonshme (si parashikohen në kontratë), i ka lindur detyrimi i pagesës së penalteteve, për ndërtimin e By-pass Fier.

-Nuk janë marrë masat për hartimin dhe miratimin e një Program Pune të detajuar se si do të arrijë të rikuperojë kohën e humbur për përmbushjen e kontratës, për ndërtimin e By-pass Fier.

-Nuk ka një kontratë zyrtare ose amendament të firmosur ku të jetë rënë dakord nga palët për vazhdimin e kontratës së punimeve të By-pass Fier. Mënyra se si ARRSH e ka menduar zgjidhjen dhe përfundimin e punimeve të ndërtimit është e pabazuar ligjërisht dhe e ka lënë në diskrecion të kontraktorit dhe të supervisorit të punimeve përfundimin e projektit. Duke qenë para kësaj shtate, si dhe duke parë dinamikën e problemeve të kontraktorit me nën kontraktorin, nga ekzistenca e urdhër sekuestrove për llogaritë e kontraktorit për shumën 247,504,223 lekë, arrijmë në konkluzionin se projekti jo vetëm që nuk e ka arritur qëllimin e tij, por për më tepër ekziston një risk për përfundimin e plot të tij.

-Projekti nuk ka arritur që të përmbush dhe realizojë parimin e 3-E-ve, që ka të bëjnë me ekonomikitetin (zbatimi me kosto sa më të ulët), efektivitetin (përfundimin në afat) dhe eficientë (shfrytëzimi në kohë sa më të shpejt i investimit). **Pra aktualisht nuk është arritur të përmirësohet udhëtimi kohor dhe i sigurt, në veçanti përmes trafikut, si dhe nuk është lehtësuar kongjestioni dhe problemet mjedisore në qytetin e Fierit.**

-Nuk janë bërë ndalesa e tatimit të të ardhurave për kompaninë “S. & S. & T.”, dhe nga PIU/ARRSH nuk është kërkuar dhe nuk është bërë ndalesa e tatimit në burim për të ardhurat e përfituar nga kompania dhe të gjeruara në

territorin e RSH, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar ku në nenin 5 pika 1 germa “ë” përcaktohet se “Tatim” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore. Për kontratën e konsulentit nuk është mbajtur për çdo pagesë tatimi në burim, veprim ky në kundërshtim me nenet 4, germa “c” dhe “h”, 7 si dhe nenin 33, germa “d” e pika 2, të ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet përkatëse, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tij, me nenet 6 pika 1, 8 pika 2 dhe 9 të ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 41, si dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangen e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”. Nga sa më sipër rezulton se për Buxheti e Shtetit është shkaktuar **një dëm ekonomik në shumën 92,386 euro.**

- Nuk ka marr masa që kontrata e punimeve të mos lidhej para se të sigurohej e gjithë shuma e financimit, pasi fondet e financimit të IPA pë By-pass Vlorë janë bërë efektive afërsisht 7 muaj pas lidhjes së kontratës së punimeve, si dhe vetë kontrata e punimeve është lidhur dy muaj para se të bëhej ratifikimi i marrëveshjes financiare për fondet IPA. Fondet e IPA janë në masën 32.08% të totalit të kontratës, veprim ky në kundërshtim me marrëveshjen financiare të datës 30.11.2011, e lidhur midis Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Europian për programin IPA 2011, në të cilin është përcaktuar se shuma e grantit për punimet e By-pass Vlorë do të bëhen efektive me ratifikimin e marrëveshjes financiare në Parlament, si dhe dy marrëveshjet bankave BEI dhe BERZH.

-Nuk ka arritur që të bëj një menaxhim të mirë të projekteve, si nga veprimi apo mospveprimi janë shkaktuar dëm ekonomik në shumën 6,190,563 euro pa TVSH dhe efekt negativ në shumën 3,985,395 euro pa TVSH.

-Nuk ka marrë masa që para lidhjes së shtesës së kontratës të konsulentit për By-pass Fier, të siguroheshin më parë burimi i financimit, veprim ky në kundërshtim me Marrëveshjet financiare të BEI dhe BERZH dhe me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar.

- Nuk ka marr masa për sinkronizimin e afateve të kontratave të lidhura për realizimin e By-pass Vlorë, pasi kontrata e mbikëqyrjes përfundon afërsisht 10 muaj para kontratës së punimeve dhe kjo mos përputhje afatesh nuk është rregulluar nga palët.

-Nuk është marr asnjë masë për të njoftuar KE për të bërë ndryshimin e afatit të implementimit të kontratës, me qëllim edhe shmangien e kostove shtesë për këtë kontratë.

-Për të dy projektet nuk ka dorëzuar te Banka/BEI informacionin në përmbajtje dhe formë, dhe kohën, e specifikuar në skedulën/formularin A.2

ose siç është rënë dakord në kontratën e financimit, veprim ky në kundërshtim marrëveshjet financiare të Bankës BEI.

-Nuk ka marr asnjë masë për të siguruar progres punimeve apo grafik punimesh, i cili nuk parashikohet në asnjë dokument se si ndiqet apo menaxhon punimet ndaj kontraktorit. Situata është jashtë marrëdhënieve kontraktuale dhe nuk ka asnjë lloj parashikimi se kur përfundojnë punimet të cilat kanë pasur afat përfundimtar datën 04.04.2016. Ekzistenca e Urdhër Sekuestros në shumën 247,504,223 lekë, paraqet risk të lartë për përfundimin e projektit.

-Nga mos menaxhimi i mirë i kontratës së punimeve, janë krijuar rrjedhimisht pagesa shtesë për konsulencën /mbikëqyrjen, duke rritur koston e projektit.

-Nuk ka ndërmarr asnjë masë për zgjidhjen e situatës së ngecjes së paraqitjes së situacioneve nga kontraktori "S.", për pagesë për shkak të urdhrit të sekuestros, ku kontraktori i janë bllokuar llogaritë bankare.

-Nuk ka kërkuar argumentime shtesë për ndryshimet e projektit të propozuara nga kontraktori, në kundërshtim me termat e referencave dhe specifikimeve të tenderit.

-Ka miratuar propozimet e ndryshimeve të rrugës, duke krijuar trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në tender.

- Nuk ka marrë masa për plotësimin e Ekipit të Zbatimit të Projektit (EZP) me specialiste/financiere, veprim ky në kundërshtim me nenin 3 të marrëveshjeve të BERZH, ku përcaktohet se për realizimin e projekteve do të funksionojë një EZP me burime të mjaftueshme dhe personel të kualifikuar. Në datën 03.11.2015 specialistja/financiere e këtij sektori është larguar dhe aktualisht ky sektor nuk ka në përbërjen e tij një specialist/ekonomist dhe vetëm autorizimi për kryerjen e pagesave i është deleguar Drejtorit të Personelit. Mungesa e specialistes së financës ka sjell dhe mos mbajtjen e llogarive të projekti, librave kontabël dhe hartimit të pasqyrave financiare të projektit rreth një periudhe një vjeçare, veprim ky në kundërshtim me marrëveshjet financiare.

***b. "Vërejtje" deri "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", neni 58, për:***

***1. z. E. H. me detyrë zëvendës Drejtor i Përgjithshëm/Drejtor i Zhvillimit të Projekteve të Huaja, të Brendshme dhe të Shpronësimeve, për arsye se:***

-Nuk është njoftuar zyrtarisht kontraktorin se për shkak të vonesave të cilat nuk kanë ardhur si pasojë e punëdhënësit apo për shkaqe të jashtëzakonshme (si parashikohen në kontratë), i ka lindur detyrimi i pagesës së penalteteve, për ndërtimin e By-pass Fier.

-Nuk janë marrë masat për hartimin dhe miratimin e një Program Pune të detajuar se si do të arrijë të rikuperojë kohën e humbur për përmbushjen e kontratës, për ndërtimin e By-pass Fierit.

-Nuk ka një kontratë zyrtare ose amendament të firmosur ku të jetë rënë dakord nga palët për vazhdimin e kontratës së punimeve të By-pass Fier. Mënyra se si ARRSH e ka bërë zgjidhjen dhe përfundimin e punimeve të ndërtimit është e pabazuar ligjërisht dhe e ka lënë në diskrecion të kontraktorit dhe të supervisorit të punimeve përfundimin e projektit. Duke qenë para kësaj shtate, si dhe duke parë dinamikën e problemeve të kontraktorit me nën kontraktorin, nga ekzistenca e urdhër sekuestrove për llogaritë e kontraktorit për shumën 247,504,223 lekë, arrijmë në konkluzionin se projekti jo vetëm që nuk e ka arritur qëllimin e tij, por për më tepër ekziston një risk për përfundimin e plot të tij.

-Projekti nuk ka arritur që të përmbush dhe realizojë parimin e 3-E-ve, që ka të bëjnë me ekonomikitetin (zbatimi me kosto sa më të ulët), efektivitetin (përfundimin në afat) dhe efikasitetin (shfrytëzimi në kohë sa më të shpejt i investimit). **Pra aktualisht nuk është arritur të përmirësohet udhëtimi kohor dhe i sigurt, në veçanti përmes trafikut, si dhe nuk është lehtësuar kongestionin dhe problemet mjedisore në qytetin e Fier.**

## ***2. Z. A. H. në cilësinë e aprovuesit të pagesave për By-pass Vlorë, për arsye se:***

- Ka miratuar pagesa pa siguruar më parë burimet e financimit, si dhe janë shkaktuar vonesa në pagesat e kontraktorit, veprime këto në kundërshtim me marrëveshjet financiare të BEI, BERZH dhe IPA 2011. Bashkëfinancues për ndërtimin e By-pass Vlorë, janë bankat BEI, BERZH dhe Konisioni Europian në shumën 17 milionë euro në formë granti nga fondet e IPA -2011, të cilat do kanalizohen nëpërmjetë bankës BERZH. Marrëveshja financiare për fondet IPA është ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë me ligjin nr. 52/2015 datë 14.05.2015 dhe ky fond është bërë efektiv më datë **30.10.2015**, njoftim i cili është bërë me fax nga banka BERZH. Fondi i financimit të IPA është bërë efektiv afërsisht 7 muaj pas lidhjes së kontratës së punimeve. Gjatë periudhës nga lidhja e kontratës deri në momentin e bërjes efektive të fondeve IPA (datë 30.10 2015), janë miratuar dy pagesa për kontratën e punimeve në shumën gjithsej 4,333,012 euro, nga të cilat shuma 1,364,237 euro duhet të likuidohen nga fondet IPA. Në fakt kjo shumë nuk ka mundur të likujdohet, për arsye se fondet IPA nuk kanë qenë efektive dhe si rrjedhojë ARSh ka miratuar pagesa pa siguruar më parë burimet e financimit, si dhe janë shkaktuar vonesa në pagesat e kontraktorit, veprime këto në kundërshtim me marrëveshjet financiare të BEI, BERZH dhe IPA 2011.

## **D. MASA ADMINISTRATIVE**

ARRSH të marri masa për të shpallur si të papranueshme për lidhjen e kontratave për punime civile kompaninë “S. C.” dhe për shërbime konsulence dhe mbikëqyrje kompaninë “S. & S. & T.”, si dhe të marrë masa për njoftimin e donatorëve BEI, BERZH, BE, Cooperzione Italiana, si dhe

Agjencinë e Prokurimit Publik për performacën e dobët të shfaqur në zbatimin e dy kontratave të ndërtimit të By-pass-eve të Fierit dhe të Vlorës, për arsye se zbatimi i tyre është shoqëruar me shkelje dhe mangësi si më poshtë:

**1. “S. C.”kontraktuar nga ARRSH për ndërtimin e dy By-pass-eve Fier dhe Vlorë, pasi:**

-Kjo shoqëri nuk ka arritur të realizojë brenda afatin të përcaktuar ndërtimin e By-pass Fier, si dhe as afatin e rishikuar nuk ka mundur ta përmbush, aktualisht kontrata e punimeve është në proces. Projekti sipas Marrëveshjeve financiare është përcaktuar të përfundonte brenda tremujorit të fundit të vitit 2015. Deri në fund të muajit gusht 2016 realizimi kohor vetëm për punimet është në masën 117% dhe janë kryer vetëm 50% e tyre (punimeve). Kontraktori S. nuk ka hartuar dhe paraqitur për miratim një grafik të detajuar për vazhdimin e punimeve, për më tepër që pas datës 4.04.2016 midis kësaj kompanie dhe ARRSH nuk ka kontratë/amendament të nënshkruar për shtyrje dhe përcaktim të afatit të përfundimit të By-pass Fier.

-Nga dinamika e zbatimit të kontratës së By-passit të Fierit, rezulton se ky kontraktor ka dështuar në realizimit e investimin brenda afateve të përcaktuara në kontratë, ku një nga shkaqet e vonesave janë çmimet anomalish të ulëta, ku është ndryshuar plotësisht projekt-preventivi i rrugës, ku janë shkelur kushtet fillestare të tenderit.

-Problematika e lindur midis kontraktorit dhe nën-kontraktorëve të punimeve, e cila ka vazhduar me dinamika të shumta deri me zgjidhjen e procesit gjyqësor, duke penguar zbatimin e punimeve. Këto vonesa janë shkaktuar nga kontraktori dhe në zbatim të kontratës FIDIC përgjegjësia është e kontraktorit. Vonesat në realizimin e By-pass Fier janë përgjegjësi e kontaktonit të punimeve.

-Ekzistenca e Urdhër Sekuestros në shumën **247,504,223 lekë për kontraktorin S.**, paraqet risk të lartë për përfundimin e projektit, fakt për të cilin nga muaji Dhjetor 2015 e deri në periudhën e auditimit, kontraktori nuk ka paraqitur asnjë certifikatë për pagesë, kjo për shkak të urdhrin të sekuestros.

-Të njëjtën situatë ky operator ka shkaktuar edhe për projektin “Ndërtimi i By-pass Vlorë”, ku nga vonesat e shkatuar nga operatori punimet kanë ecur me ritme shumë të ngadalta deri në stopim të punimeve dhe deri në fund të muajit gusht realizimi fizik është në masën 5.6%, realizimi financiar në masën 14% dhe realizimi kohor në masën 60%, pra tregues të cilët janë në përpjesëtim të zhdrejtë me njëri –tjetrin.

-Ka situacionuar dhe ka përfituar pagesë për punime të pakryera gjatë zbatimit të kontratës së punimeve për By-pass Fier në shumën gjithsej 2,065,217 euro.

## 2. "S. & S. & T.", kontraktua nga ARRSH për mbikëqyrjen dhe kosulencën e kontratës së punimeve të ndërtimit për By-pass-in e Fierit pasi;

-Nuk ka nxitur kontraktorin S. për nxitjen e punimeve dhe nuk ka paraqitur dhe konsultuar ARRSH për ti dhënë një zgjidhje optimale për ngërçin e shkaktuar në punimet e ndërtimit.

-Ka miratuar dhe certifikuar punime të pa kryera por të përfituara nga kontraktori "S." për kontratën e punimeve për ndërtimin ne By-pass Fier, në shumën 2,065,217 euro.

- Kompania nuk ka plotësuar dhe dorëzuar në ARRSH ose në Drejtorinë e Tatimeve, formularët për shmangien e tatimit të dyfishtë, në zbatim të marrëveshjes bilaterale për shmangen e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, si dhe nuk ka zbatuar detyrimet që lindin nga kuadri ligjor për procedurat tatimet në RSH dhe si rrjedhojë nuk ka derdhur tatimin e të ardhurave në shumën 92,386 euro,duke sjell dem ekonomik për buxhetin e shtetit.

- Ka miratuar uljet e kuotave të rrugës (lartësia e trupit të rrugës), propozuara nga kontraktori, pa u mbështetur në arsytetime teknike të argumentuara, por faktikisht është mbështetur në raportin hidrologjikë, i cili në të dy vitet kur është paraqitur (viti 2011 dhe viti 2014) është i njëjtë. Propozimi i kontraktorit miratuar fillimisht nga konsulenti, i cili është njëkohësisht edhe projektuesi i projektit të tenderuar, por njëkohësisht ka miratuar po të njërin projekt të paraqitur nga një projektues tjetër (S. B.), por ky i fundit ka ndryshuar edhe specifikimet teknike dhe preventivin e punimeve, të cilat janë pjesë integrale e kontratës së punimeve. Ndryshimit i kuotave të projektit të rrugës me të njëjtin studim hidrologjik-hidraulik, tregon një menaxhim të dobët të ARRSH, duke denatyruar projektin e tenderuar dhe duke krijuar risk të lart të mundshëm për përmbytjen në disa segmente të rrugës.

## **E. KALLËZIM PENAL**

**Bazuar në ligjin nr.7905 datë 21.03.1995 "Kodi i procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 281, për shkelje të konstatuara nga grupi i auditimit, për projektet "Ndërtimi By-pass Fier" dhe "Ndërtimi i By-pass Vlorë", i sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal.**

**Shënim:** Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit janë konstatuar përgjegjësi për ish- financieren e projekteve znj A. Sh., për të cilën nuk

rekomandojmë masë disiplinore duke e konsideruar të ezauruar, për arsye se ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me ARRSH.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**